

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KRUJË  
KESHILLI I BASHKISË

VENDIM

NR 92 DATE 20 / 02 /2017

**“Per dhenien e titujve vendore te nderit”**

Keshilli Bashkiak Kruje, ne mbledhjen e tij te dates 20. 02. 2017, pasi mori ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Bashkia Kruje dhe propozimin e komisionit keshillimor “Per dhenien e titujve vendore te nderit”, ne mbeshtetje te Ligjit nr 139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore”, te ligjit nr. 112/2013 “Per dekoratat , titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore te nderit ne Republikën e Shqiperise “ I ndryshuar

**VENDOSI**

1-Te miratoje dhenien e titujve vendore te nderit si me poshte:

**“ Krenaria krutane pas vdekjes “**

z.Ali Goga dhe z. Latif Nuna me motivacionin: “ Per kontribut te vyer ne krijimin dhe drejtimin artistik me perkushtim te grupit karakteristik te pleqve et Krujes, per 35 vjet me rralle duke percjelle ne breza pasqyrimin e vlerave te artit muzikor tradicional krutan”

3- Meleqe Llubani

**“Per kontributin e palodhur te saj si hulumtuese dhe bartese e folklorit krutan, vlera qe pasuruan dhe ushqyen brezat artiste ne te gjitha Festalet Folklorike Kombetare”**

4-Vogel Taga , Hahja Caca, Qamil, Qoshja, Xhemal Kulli, Rexhep Goga, Muharrem Sulejmani, Ali Copani, Muharrem Stafa,

5- Jahja Mallkuci, Deshire Maja, Muharrem Loci, Mustafa Aruci, Enver Tufa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KRUIË  
KESHILLI I BASHKISË

Me motivacionin:

“Per interpretimin dinjitoz dhe plot dashuri te folkut muzikor vocal, instrumental, gojor humoristik krutan, duke percjelle ne breza pasionin per kultivimin dhe ruajtjen e artit tradicional si vlere e identitetit kombetar”.

6-Hamdi Meca, me motivacionin: “ Poet, shkrimtar me kontribut te vyer edhe si mbledhes I folklorit gojor, levrimi I se ciles e ka ndihmuar edhe si tekst shkruer per repertorin e grupit karakteristik te Krujes”.

Dhenien e titullit “Mirenjohja Krutane”;

z. Hysen LLubani me motivacionin:

“ Per nje pune te palodhur dhe pasionante per riorganizimin e grupit karakteristik te pleqve ne vitet '70 , duke e rritur veprimtarine e tij ne vlerat interpretative me reputacion ne te gjitha trevat shqiptare”

Zj.Adelina Shehu (Hoxha) me motivacionin:” Per kontribut pasionant dhe deshireplote ne promovimin e veprimtarise artistike popullore te grupit karakteristik te pleqve, vlere e gjalle e trashegimise kulturore krutane”.

z.Asllan Sula , ti jepet tituli “Fisnikeria Krutane” me motivacionin : “ Vizionar ne njohjen e trashegimise shpirtore dhe turizmit kulturor krutan, per ruajtjen e te cilave , kontributi I tij eshte materializuar me donacionet e pakursyera sidomos ne drejtim te promovimit te aktivitetit te grupit karakteristik te pleqve te Krujes , ne nivelet kometare dhe mbarekombetare”.

2-Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

KRYETARI I KESHILLIT

